



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:180863

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06506991

KPPP.nr. 1004/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.H.B.I., me numër të biznesit ... dhe seli në Prishtinë, rr. "...", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ardiana Azemi, avokate nga Prishtina, kundër debitorit D.P Partners Sh.P.K., me numër unik identifikues 811302471 dhe seli në Prishtinë, rr. "Enver Maloku", Kompleksi Tregtia, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 150/24 të datës 07.06.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 26.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit D.P Partners Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 150/24 i datës 07.06.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 EUR, (dyqind e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B.H.B.I., me datë 07.06.2024, ka lëshuar urdhrin P.nr. 150/24, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit, Faturës nr. 01/2023 e datës 15.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin D.P Partners Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit shumën prej 11,523.43 EUR (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet

e tre euro e dyzet e tre cent), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor, me arsyetimin se është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, ku gabimisht është konstatuar gjendja faktike, pasi që fatura nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk është e përshtatshme për përbarim, duke mos përcaktuar kohën e përmbushjes së detyrimit, andaj nuk janë plotësuar kërkesat ligjore sipas nenit 29, par. 1, nën par. 1.3 lidhur me nenin 37 dhe 38 të LPP-së. Ka shtuar se urdhrin përbarimor e kundërshton në bazë të dispozitës së nenit 71 të LPP-së, ku dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë, e po ashtu kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin në bazë të dokumentit përbarues. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor ta anulojë, si dhe të kompensojë shpenzimet për përpilimin e prapësimit në shumë prej 416.00 EUR.

Kreditori, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se nuk ka ofruar ndonjë provë me të cilën do të mbështeste pretendimet e tij, sipas nenit 69, par. 4 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor nuk është kundërshtuar nga debitori, mirëpo e njëjta është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhrin përbarimor ta vërtetojë. Shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*

monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbaerim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Faturës nr. 01/2023, e datës 15.06.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbaerim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbaerimit pasi që është e përshtatshme për përmbaerim.

Pretendimet e debitorit se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbaerimor nuk është e përshtatshme për përmbaerim meqenëse nuk përmban afatin e përmbushjes gjykata e vlerësoi si të paqëndrueshëm pasi që nga shkresat e lëndës rezultoi se kreditori, ka paraqitur deklaratë për arritshmërinë e kredisë përmes të cilës ka deklaruar se fatura objekt i këtij përmbaerimi është bërë e arritshme me datë 15.06.2023, deklaratë kjo në përputhje me nenin 30 të LPP-së me të cilin përcaktohet se *“Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbaerimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”.*

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaerimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbaerimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i’u njohur shpenzimet përfaqësueses së kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej EUR 208.00 EUR, konform rregullores në fuqi për tarifatat e avokatëve, nr. tarifor 6, lidhur me përpilimin e parashtresave për përmbaerimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 EUR e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1004/24, datë 26.11.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.